



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

PROVIMET KOMBËTARE TË ARSIMIT BAZË 2024 (KLASA 9-të)

RAPORT PUBLIK

MBI

ARRITJET E NXËNËSVE

Përmbledhja

<u>Hyrje</u>	3
<u>Tabela e shkurtimeve</u>	3
<u>1. Metodologjia</u>	4
<u>2. Statistika përmbledhëse për PKAB 2024</u>	5
<u>3. Statistika Krahasuese PKAB 2022-2024</u>	6
<u>I. Lënda: Gjuhë Shqipe</u>	7
<u>1.1 Arritjet e nxënësve</u>	7
<u>1.2 Arritjet në nivel kombëtar</u>	10
<u>1.3 Arritjet sipas gjinisë</u>	11
<u>1.4 Arritjet sipas vendbanimit urban/rural</u>	11
<u>1.5 Arritjet sipas sistemit publik/jopublik të edukimit</u>	12
<u>1.6 Qëndrueshmëria e arritjeve</u>	12
<u>1.7 Qëndrueshmëria e arritjeve sipas vendbanimit urban/rural</u>	14
<u>1.8 Arritjet sipas gjinisë vajza/djem</u>	16
<u>1.9 Të dhëna të tjera për rezultatet e provimit të Gjuhës shqipe</u>	19
<u>II. Lënda: Matematikë</u>	22
<u>2.1 Arritjet e nxënësve</u>	22
<u>2.2 Arritjet në nivel kombëtar</u>	24
<u>2.3 Arritjet sipas vendbanimit urban/rural</u>	25
<u>2.4 Arritjet sipas gjinisë</u>	25
<u>2.5 Arritjet sipas sistemit publik/jopublik të edukimit</u>	26
<u>2.6 Qëndrueshmëria e arritjeve</u>	26
<u>2.7 Arritjet sipas vendbanimit urban/rural</u>	29
<u>2.8 Arritjet sipas gjinisë vajza/djem</u>	30
<u>2.9 Të dhëna të tjera për rezultatet e provimit të Matematikës</u>	32
<u>III. Lënda: Gjuhë e Huaj</u>	34
<u>3.1 Arritjet e nxënësve</u>	34
<u>3.2 Arritjet në nivel kombëtar</u>	38
<u>3.3 Arritjet sipas vendbanimit urban/rural</u>	38
<u>3.4 Arritjet sipas gjinisë</u>	38
<u>3.5 Arritjet sipas sistemit publik/jopublik të edukimit</u>	38
<u>3.6 Të dhëna të tjera për rezultatet e provimit të Gjuhës së huaj</u>	39
<u>IV. Renditja e shkollave në bazë të mesatares së arritjeve në Provimet Kombëtare të Arsimit Bazë</u> ..	45

Hyrje

Matja e arritjeve të nxënësve në përfundim të një niveli arsimor shërben jo vetëm për të pasqyruar funksionimin e sistemit arsimor dhe kontekstin e politikave arsimore aktuale, por edhe për të ndërtuar politika të reja arsimore. Rezultatet e nxënësve përfaqësojnë treguesin kryesor të cilësisë dhe të performancës së sistemit arsimor, sidomos kur kjo lidhet me synimin për pajisjen e nxënësve me njohuri dhe me kompetenca për përballimin e kërkesave të kohës.

Raporti publik i Provimeve Kombëtare të Arsimit Bazë 2024 shërben për t'u siguruar politikëbërësve, përdoruesve dhe publikut informacion për rezultatet e nxënësve dhe për faktorët që ndikojnë në to. Ai synon të kontribuojë në zhvillimin dhe analizën e treguesve sasiorë krahasimorë të vlerësimit të jashtëm të arritjeve të nxënësve të klasës së nëntë.

Informacioni është i organizuar në mënyrë të tillë që mundëson jo vetëm njohjen e arritjeve të nxënësve në nivel ZVAP-je, por njëkohësisht edhe krahasimin mes ZVAP-ve, duke iu referuar edhe arritjeve në nivel kombëtar.

Tabela e shkurtimeve

MAS – Ministria e Arsimit dhe Sportit

QSHA – Qendra e Shërbimeve Arsimore

ZVAP – Zyra Vendore Arsimit Parauniversitar

PKAB – Provimi Kombëtar i Arsimit Bazë

NV – Nota Mesatare Vjetore

NP – Nota Mesatare e Provimit

NVK – Nota Mesatare Vjetore në nivel Kombëtar

NPK – Nota Mesatare e Provimit në nivel Kombëtar

1. Metodologjia

Informacioni statistikor i këtij raporti është bazuar në databazën e krijuar nga QSHA gjatë procesit të organizimit dhe realizimit të Provimeve Kombëtare të Arsimit Bazë 2024 (këtu e në vijim PKAB). Baza e të dhënave përmban informacion statistikor në nivel nxënësi mbi arritjet në lëndët: Gjuhë shqipe, Matematikë dhe Gjuhë e huaj.

Fushat kryesore të bazës së të dhënave janë:

- ZVAP (së cilës i përket shkolla që ka ndjekur nxënësi);
- shkolla e ndjekur;
- gjinia e nxënësit;
- lloji i shkollës (publike/jopublike);
- vendndodhja e shkollës (urbane/rurale);
- kalueshmëria gjatë vitit shkollor 2023-2024;
- pikët e fituara në provime nga çdo nxënës;
- notat në provimet e arsimit bazë;
- notat vjetore të fituara nga nxënësit gjatë vitit shkollor (për lëndët e provimeve të arsimit bazë).

Të dhënat mbi arritjet mesatare të nxënësve në **PKAB** 2024 janë paraqitur:

- në nivel kombëtar;
- në nivel ZVAP-je;
- sipas vendbanimit (urban/rural);
- sipas gjinisë (vajza/djem);
- sipas llojit të shkollës (publike/jopublike).

Në përpunimin statistikor të të dhënave, janë përfshirë të dhënat e arritjeve të nxënësve të vitit shkollor 2023-2024, të cilët morën pjesë në **PKAB** 2024, në sesionin e parë. Informacioni statistikor i përfutur nga përpunimi është paraqitur në formë tabelore dhe/ose grafike.

Raporti përmban treguesit e mëposhtëm statistikorë:

- mesatarja e pikëve të fituara në testim;
- nota mesatare vjetore (NV);
- nota mesatare e provimit (NP);
- shmangia standarde - (*shmangia mesatare e të dhënave nga mesatarja e tyre*);
- nota mesatare vjetore në nivel kombëtar (NVK);
- nota mesatare e provimit në nivel kombëtar (NPK);
- kalueshmëria në provimin kombëtar të Arsimit Bazë;
- diferenca e Notës Vjetore me Notën Vjetore në nivel kombëtar (NV – NVK);
- diferenca e Notës së provimit me Notën e provimit në nivel kombëtar (NP – NPK).

2. Statistika përmbledhëse për PKAB 2024

Tabela 1.1: Të dhëna statistikore përmbledhëse për provimet e PKAB 2024.

Nr.	Lënda	Numri i nxënësve që morën pjesë në PKAB		
		Total	Publik	Jopublik
1	Gjuhë shqipe (Total)	27421	24721	2700
	Urbane	16701	14126	2575
	Rurale	10720	10595	125
	Vajza	13436	12074	1362
	Djem	13985	12647	1338
2	Matematikë (Total)	27417	24715	2702
	Urbane	16693	14117	2576
	Rurale	10724	10598	126
	Vajza	13434	12072	1362
	Djem	13983	12643	1340
3	Gjuhë e Huaj (Total)	27435	24729	2706
	Urbane	16709	14129	2580
	Rurale	10726	10600	126
	Vajza	13437	12075	1362
	Djem	13998	12654	1344

Tabela 1.1, paraqet të dhëna statistikore përmbledhëse për PKAB 2024, për sesionin e parë. Në tabelën 1.1 është paraqitur numri i nxënësve sipas lëndëve/provimeve të Arsimit Bazë 2024, të klasifikuar sipas kategorive: publike/jopublike, urbane/rurale, vajza/djem, arritjet e të cilëve janë përdorur për përgatitjen e këtij raporti.

3. Statistika Krahasuese PKAB 2022-2024

Tabela 1.2: Të dhëna statistikore përmbledhëse për dy vitet e fundit.

Nr.	Lënda	Numri i nxënësve që morën pjesë në provim			Kalueshmëria në provim	Nota mesatare në PKAB
		Total	Publik	Jopublik	(në %)	
2024						
1	Gjuhë shqipe	27421	24721	2700	99.78%	7.92
2	Matematikë	27417	24715	2702	99.94%	7.67
3	Gjuhë e Huaj	27435	24729	2706	99.96%	8.66
Të gjitha lëndët		82273	74165	8108	99.89%	8.08
2023						
1	Gjuhë shqipe	28205	25590	2615	99.70%	8.29
2	Matematikë	28212	25608	2604	99.79%	7.43
3	Gjuhë e Huaj	28552	25923	2629	99.98%	8.73
Të gjitha lëndët		84969	77121	7848	99.82%	8.15
2022						
1	Gjuhë shqipe	28957	26601	2356	99.84 %	8.19
2	Matematikë	28986	26626	2360	99.90 %	7.45
3	Gjuhë e Huaj	28859	26506	2353	99.92 %	8.47
Të gjitha lëndët		86802	79733	7069	99.88 %	8.03

Tabela 1.2, paraqet të dhëna statistikore përmbledhëse për PKAB 2022 - 2024.

Nga krahasimi i të dhënave të **PKAB** të dy viteve të fundit, për të gjitha lëndët rezultojnë se:

- kalueshmëria e nxënësve në **PKAB 2024**, është **0.07%** më e lartë në krahasim me vitin **2023**, dhe **0.01%** më e lartë së viti **2022**.
- nota mesatare, krahasuar me vitin **2023** është **0.07** njësi note më e ulët, ndërsa krahasuar me vitin **2022** është **0.05** njësi note më e lartë.

I. Lënda: Gjuhë Shqipe

1.1 Arritjet e nxënësve

Në provimin e lëndës së Gjuhës shqipe morën pjesë **27421** nxënës. **Tabela 1.3** paraqet pikët mesatare të fituara nga nxënësit e çdo ZVAP-je në **PKAB**, të lëndës Gjuhë Shqipe.


Tabela 1.3: Arritjet mesatare për çdo ZVAP.

Nr	ZVAP	Pikë mesatare	Shmangia mesatare	Nota mesatare e provimit	Shmangia mesatare	Nota mesatare vjetore	Shmangia mesatare
	Në nivel kombëtar	32.68	10.19	7.92	1.41	7.49	1.71
1	Belsh	35.57	9.36	8.29	1.29	7.60	1.61
2	Berat	34.47	9.70	8.16	1.34	7.77	1.71
3	Bulqizë	26.42	10.68	7.10	1.49	6.86	1.78
4	Cërrik	30.07	10.73	7.54	1.52	7.46	1.78
5	Devoll	32.86	9.21	7.92	1.28	7.46	1.83
6	Dibër	28.11	9.23	7.30	1.29	7.03	1.63
7	Dimal	28.08	10.90	7.33	1.53	7.33	1.65
8	Divjakë	30.97	8.86	7.68	1.23	7.38	1.73
9	Durrës	33.96	9.60	8.09	1.33	7.47	1.73
10	Elbasan	35.63	10.27	8.29	1.39	7.42	1.72
11	Fier	32.74	9.65	7.92	1.33	7.45	1.68
12	Finiq-Dropull	38.73	10.24	8.67	1.47	8.02	1.69
13	Gjirokastrë-Libohovë	35.81	10.09	8.33	1.37	7.70	1.79
14	Gramsh	34.78	8.66	8.19	1.21	7.69	1.73
15	Has	29.81	9.79	7.55	1.40	7.95	1.64
16	Kamëz	29.28	9.40	7.46	1.33	7.01	1.67
17	Kavajë	32.68	10.94	7.89	1.53	7.31	1.78
18	Klos	30.87	10.16	7.61	1.43	7.50	1.79
19	Kolonjë	28.92	10.47	7.38	1.56	7.56	1.82
20	Korçë-Pustec	34.96	9.93	8.23	1.37	7.76	1.80
21	Krujë	30.08	9.55	7.56	1.19	7.19	1.62
22	Kuçovë	30.66	10.12	7.62	1.41	7.19	1.64
23	Kukës	28.58	9.97	7.38	1.40	7.38	1.67
24	Kurbin	32.03	10.82	7.83	1.53	7.50	1.82
25	Lezhë	31.49	9.16	7.76	1.29	7.46	1.65
26	Librazhd	32.04	8.88	7.79	1.24	7.56	1.66
27	Lushnje	34.63	9.90	8.14	1.37	7.46	1.77
28	Malësi e Madhe	31.28	10.31	7.76	1.41	7.15	1.53
29	Maliq	30.53	9.60	7.61	1.30	7.06	1.74

30	Mallakastër	33.24	8.74	7.98	1.20	7.65	1.56
31	Mat	30.53	10.44	7.59	1.47	7.21	1.69
32	Mirditë	30.19	10.04	7.59	1.45	7.36	1.51
33	Patos	29.69	9.08	7.54	1.26	7.22	1.60
34	Peqin	32.90	10.94	7.94	1.59	7.87	1.60
35	Përmet-Këlcyrë	30.74	9.73	7.72	1.29	7.06	1.55
36	Pogradec	32.17	9.66	7.86	1.39	7.62	1.70
37	Poliçan	34.20	8.20	8.09	1.12	7.25	1.60
38	Prrenjas	33.55	9.27	8.01	1.26	7.50	1.67
39	Pukë-Fushë Arrëz	31.17	11.17	7.69	1.54	7.81	1.61
40	Roskovec	26.20	10.04	7.03	1.47	7.18	1.68
41	Rrogozhinë	30.24	10.37	7.58	1.45	7.17	1.76
42	Sarandë-Konispol-Delvinë	32.68	10.15	7.88	1.40	7.41	1.66
43	Selenicë	34.56	9.37	8.20	1.31	7.87	1.68
44	Shijak	30.30	11.24	7.57	1.54	7.28	1.78
45	Shkodër	33.49	10.13	8.04	1.40	7.40	1.75
46	Skrapar	30.56	9.17	7.64	1.24	7.29	1.62
47	Tepelenë-Memaliaj	26.77	8.80	7.14	1.21	7.44	1.69
48	Tiranë	33.83	10.21	8.08	1.42	7.74	1.70
49	Tropojë	35.37	10.78	8.28	1.45	7.74	1.56
50	Vau Dejës	27.75	9.10	7.26	1.27	6.94	1.60
51	Vlorë-Himarë	35.03	10.57	8.21	1.45	7.60	1.65
52	Vorë	33.36	9.40	7.99	1.31	7.22	1.62

Të dhënat e kësaj tablele janë paraqitur në **Grafikun 1.1**. Grafiku tregon mesataret e pikëve të secilës ZVAP, duke i krahasuar ato me mesataren e pikëve në nivel kombëtar që është **32.68 pikë/nxënës**.

Grafiku 1.1: Arritjet mesatare për çdo ZVAP.



1.2 Arritjet në nivel kombëtar

- **Mesatarja e pikëve** të fituara në provimin e Gjuhës shqipe është **32.68 pikë**, me shmangie mesatare **10.19**.
- **Nota mesatare e provimit** është **7.92**, me shmangie mesatare **1.41**.
- **Nota mesatare vjetore** është **7.49**, me shmangie mesatare **1.71**.

Nga krahasimi i vlerave të notës mesatare vjetore me notën mesatare të provimit të arsimit bazë, referuar po nivelit kombëtar, rezulton se nota mesatare e provimit kombëtar është **0.43** njësi notë më e lartë se nota mesatare vjetore.

Gjithashtu, vëmë re se pothuajse në të gjitha ZVAP-të, arritjet mesatare të nxënësve në provim janë më të larta, sesa arritjet mesatare të tyre gjatë vitit. ZVAP Elbasan, dallohet për diferencë më të lartë midis notës vjetore dhe asaj së provimit (nota mesatare vjetore **7.42**, nota mesatare e provimit **8.29**). Arritjet mesatare të nxënësve në provim janë më të ulëta krahasuar me arritjet mesatare vjetore, në ZVAP Has, nota mesatare vjetore është **0.40** njësi note më e lartë se nota mesatare e provimit kombëtar.

Tabela 1.4: Arritjet mesatare të nxënësve sipas kategorive.

Urbanizimi	Gjinia	Pikët e fituara në test		Nota e PKAB		Nota Vjetore	
		Mesatarja e pikëve	Shmangia mesatare	Nota mesatare	Shmangia mesatare	Nota mesatare	Shmangia mesatare
Në nivel kombëtar	Vajza	36.48	9.09	8.43	1.26	8.17	1.53
	Djem	29.03	9.86	7.42	1.37	6.83	1.63
	Grand Total	32.68	10.19	7.92	1.41	7.49	1.71
Urbane	Vajza	38.14	8.57	8.66	1.20	8.32	1.51
	Djem	31.10	9.93	7.70	1.38	7.06	1.68
	Total	34.58	9.93	8.17	1.38	7.68	1.72
Rurale	Vajza	33.83	9.27	8.07	1.27	7.94	1.52
	Djem	25.88	8.86	7.00	1.24	6.49	1.48
	Total	29.72	9.89	7.52	1.37	7.19	1.67
Publik (në nivel kombëtar)	Vajza	35.93	9.14	8.36	1.27	8.09	1.54
	Djem	28.26	9.66	7.32	1.35	6.71	1.59
	Total	32.01	10.17	7.82	1.41	7.38	1.71
Urbane	Vajza	37.55	8.70	8.58	1.22	8.21	1.54
	Djem	30.14	9.85	7.57	1.37	6.89	1.65
	Total	33.79	10.01	8.06	1.39	7.54	1.73
Rurale	Vajza	33.73	9.27	8.06	1.27	7.92	1.52
	Djem	25.79	8.84	6.99	1.24	6.47	1.47

	Total	29.63	9.88	7.51	1.37	7.17	1.66
Jopublik (në nivel kombëtar)	Vajza	41.31	6.92	9.09	0.98	8.90	1.22
	Djem	36.35	8.57	8.43	1.19	8.02	1.47
	Total	38.85	8.17	8.76	1.14	8.46	1.41
Urbane	Vajza	41.28	6.99	9.08	0.98	8.88	1.22
	Djem	36.50	8.58	8.46	1.20	8.05	1.46
	Total	38.92	8.17	8.77	1.14	8.47	1.41
Rurale	Vajza	41.89	5.19	9.20	0.83	9.20	1.06
	Djem	33.44	7.87	8.00	1.05	7.52	1.47
	Total	37.56	7.90	8.58	1.12	8.34	1.53

Tabela 1.4 paraqet arritjet mesatare të nxënësve në lëndën e Gjuhës shqipe. Arritjet e nxënësve janë dhënë në nivel kombëtar, sipas vendbanimit urban/rural, sipas gjinisë vajza/djem, si edhe sipas sistemit publik/jopublik të edukimit.

1.3 Arritjet sipas gjinisë

Krahasueshmëria mes arritjeve mesatare të vajzave dhe djemve, për nivelin kombëtar, tregon se:

- arritjet mesatare për vajzat janë më të larta, krahasuar me arritjet mesatare të djemve;
- mesatarja e pikëve të fituara nga vajzat është rreth **7.45 pikë** më e lartë, krahasuar me mesataren e pikëve të fituara nga djemtë.

Nëse krahasojmë diferencat që ekzistojnë mes arritjeve të nxënësve-vajza, në provimet kombëtare, me arritjet vjetore të tyre, rezulton se vajzat kanë një qëndrueshmëri më të mirë (nota mesatare në **PKAB** është **8.43**, kundrejt **8.17** që është nota mesatare vjetore).

Nëse krahasojmë diferencat që ekzistojnë mes arritjeve të nxënësve-djem, në provimet kombëtare, me arritjet vjetore të tyre, rezulton se djemtë kanë marrë një vlerësim më të lartë në rezultate në provimin e arsimit bazë, kundrejt arritjeve vjetore të tyre (nota mesatare në **PKAB** është **7.42**, kundrejt **6.83** që është nota mesatare vjetore) .

1.4 Arritjet sipas vendbanimit urban/rural

Nëse do të analizojmë arritjet e nxënësve, në nivel kombëtar, sipas elementëve të vendbanimit urban/rural, rezulton se:

- ekzistojnë diferenca mes arritjeve të nxënësve që kanë ndjekur shkollën në zonat urbane, kundrejt atyre që e kanë ndjekur shkollën në zonat rurale;
- mesatarja e pikëve të fituara nga nxënësit e zonave urbane rezulton të jetë rreth **4.86 pikë** më e lartë, ndaj nxënësve të zonave rurale.

Ekzistenca e diferencës prej **4.86 pikësh** në mesataren e pikëve pasqyrohet edhe në diferencën e notës mesatare të **PKAB**-së që ekziston mes dy kategorive, vlera e së cilës është me **0.65** njësi note.

Në nivel kombëtar, diferencat e arritjeve midis kategorive urbane dhe rurale janë përkatësisht: për vajzat **4.31** pikë, ndërsa për djemtë **5.22** pikë.

Për të tre treguesit statistikorë të tabelës 1.4, shihet se arritjet e vajzave në zonat urbane janë më të larta kundrejt arritjeve të vajzave të zonave rurale.

Nëse i referohemi arritjeve mesatare vjetore, vajzat e zonave urbane kanë një notë mesatare vjetore me një vlerë prej **0.38** më të lartë se vajzat e zonave rurale. Kjo diferencë arrin deri në **0.59** njësi note, nëse i referohemi arritjeve në provimin kombëtar të arsimit bazë.

Nëse i referohemi arritjeve mesatare vjetore, djemtë e zonave urbane kanë një notë mesatare vjetore me një vlerë prej **0.57** më të lartë se djemtë e zonave rurale. Kjo diferencë arrin deri në **0.70** njësi note, nëse i referohemi arritjeve në provimin kombëtar të arsimit bazë.

1.5 Arritjet sipas sistemit publik/jopublik të edukimit

Diferenca ekziston edhe mes dy sistemeve arsimore (publik/jopublik). Nga të dhënat e tabelës 1.4, rezulton se arritjet mesatare të nxënësve në sistemin jopublik të edukimit janë më të larta se arritjet mesatare të nxënësve në sistemin publik.

Kjo situatë qëndron si për mesataren e pikëve në provim, po ashtu edhe për notën mesatare të provimit dhe atë vjetore.

Të njëjtat dallime ekzistojnë, edhe nëse krahasojmë arritjet e nxënësve vajza/djem në sistemin publik me arritjet e nxënësve vajza/djem në sistemin jopublik, si edhe për kategoritë urbane/rurale në sistemin publik, kundrejt kategorive urbane/rurale në sistemin jopublik.

1.6 Qëndrueshmëria e arritjeve

Nëse do të analizojmë qëndrueshmërinë e arritjeve të nxënësve në provimin e arsimit bazë, kundrejt arritjeve vjetore, duke krahasuar notën mesatare vjetore me notën mesatare të provimit, shihet se qëndrueshmëria e arritjeve në sistemin publik është (**0.44**) dhe për atë jopublik (**0.3**).

Paqëndrueshmëria më e madhe vihet re në kategorinë - djem si në sistemin publik (**0.61**), ashtu edhe në atë jopublik (**0.41**). Vajzat kanë arritje më të qëndrueshme krahasuar me djemtë. Për sistemin publik, për kategorinë - vajza, diferenca midis notës mesatare të PKAB me notën mesatare vjetore është vetëm (**0.27**) dhe në atë jopublik vetëm (**0.19**).


Tabela 1.5 dhe **Grafiku 1.2**, paraqesin shpërndarjen (në përqindje) të notave të provimit të arsimit bazë për lëndën e Gjuhës shqipe.

Tabela 1.5: Shpërndarja e notave të provimit të arsimit bazë.

Sistemi i edukimit	Nota e PKAB-së në Gjuhën Shqipe						
	Nota 4	Nota 5	Nota 6	Nota 7	Nota 8	Nota 9	Nota 10
Publik	0.22%	4.83%	11.26%	21.10%	22.33%	17.71%	12.71%
Jopublik	0.00%	0.09%	0.25%	1.04%	2.25%	3.09%	3.13%
Në nivel kombëtar	0.22%	4.92%	11.51%	22.14%	24.59%	20.80%	15.83%

Grafiku 1.2: Shpërndarja e notave të provimit të arsimit bazë.

Shpërndarja e notave të PKAB-së në Gjuhën Shqipe



Në nivel kombëtar, në provimin e arsimit bazë, lënda Gjuhë Shqipe:


- kalueshmëria është **99.78%**;
- nota me përqindjen më të lartë është **nota 8 me 24.59%**;
- përqindja e nxënësve të vlerësuar me **notën 10** në nivel kombëtar për PKAB 2024 është e lartë (**15.83%**).

Tabela 1.6: *Shpërndarja e notave vjetore.*

Sistemi i edukimit	Nota vjetore në Gjuhën Shqipe					
	Nota 5	Nota 6	Nota 7	Nota 8	Nota 9	Nota 10
Publik	16.37%	16.43%	14.95%	15.43%	12.69%	14.29%
Jopublik	0.28%	0.75%	1.46%	2.20%	1.94%	3.21%
Në nivel kombëtar	16.65%	17.18%	16.41%	17.63%	14.63%	17.50%

Tabela 1.6 dhe **Grafiku 1.3**, paraqesin shpërndarjen e notave vjetore për lëndën e Gjuhës shqipe.

Grafiku 1.3: Shpërndarja e notave vjetore.



1.7 Qëndrueshmëria e arritjeve sipas vendbanimit urban/rural

Në **tabelën 1.7** paraqiten përqindjet për notat e provimit të PKAB-së dhe ato vjetore sipas vendbanimit urban dhe rural.

- të dhënat tregojnë se përqindja e nxënësve që kanë marrë notën 10 në provimin e Arsimit Bazë është 15.83% e totalit të nxënësve, prej të cilëve 3.29% janë nxënës që i përkasin zonave rurale dhe 12.54% i përkasin zonave urbane;
- rezultatet e arritura në provimin e arsimit bazë, si dhe ato vjetore të nxënësve të zonave urbane janë përgjithësisht më të larta kundrejt rezultateve të nxënësve të zonave rurale;
- në notat e provimit të arsimit bazë, nxënësit e zonave urbane e kanë përqindjen më të lartë në notën 8 ndërsa nxënësit e zonave rurale e kanë përqindjen më të lartë në notën 7. Për notën 10, përqindja e nxënësve të zonave urbane është më e lartë krahasuar me nxënësit e zonave rurale;
- totali i arritjeve të nxënësve për intervalin e notave 4-6 është më i lartë në zonat rurale krahasuar me ata të zonave urbane, ndërsa për notat 7-10 ndodh e kundërta. Në këtë interval note 7-10 përqindja e nxënësve të zonave urbane është më e lartë.

Tabela 1.7: Arritjet në PKAB sipas urbanizimit.

Urbanizimi	Nota e PKAB-së në Gjuhën Shqipe						
	Nota 4	Nota 5	Nota 6	Nota 7	Nota 8	Nota 9	Nota 10
Urbane	0.13%	2.07%	5.16%	11.86%	14.81%	14.34%	12.54%
Rurale	0.09%	2.85%	6.35%	10.28%	9.77%	6.45%	3.29%
Në nivel kombëtar	0.22%	4.92%	11.51%	22.14%	24.59%	20.80%	15.83%

Grafiku 1.4: Arritjet në PKAB-së sipas urbanizimit.





Tabela 1.8: Arritjet vjetore sipas urbanizimit.

Urbanizimi	Notat vjetore në Gjuhën Shqipe					
	Nota 5	Nota 6	Nota 7	Nota 8	Nota 9	Nota 10
Urbane	8.60%	9.42%	9.61%	11.22%	9.20%	12.85%
Rurale	8.05%	7.76%	6.79%	6.41%	5.42%	4.66%
Në nivel kombëtar	16.65%	17.18%	16.41%	17.63%	14.63%	17.50%

Në tabelën 1.8, paraqiten përqindjet për arritjet vjetore në lëndën e Gjuhës Shqipe të kategorisë urbane/rurale.

Grafiku 1.5: Arritjet vjetore sipas urbanizimit.



1.8 Arritjet sipas gjinisë vajza/djem

Nga të dhënat e paraqitura më poshtë (në formë tabelore dhe grafike) për arritjet në provimin kombëtar, si dhe ato për arritjet gjatë vitit shkollor, mund të veçojmë:

Për provimin e arsimit bazë:

- vajzat kanë rezultate më të larta se djemtë, si gjatë vitit shkollor po ashtu edhe në provimin e arsimit bazë;
- vajzat kanë përqindjen më të lartë në notën 9 me **13.60%** për arritjet në provimin e arsimit bazë, ndërkohë djemtë kanë notën 7 me **14.63%**;
- vajzat kanë përqindjen më të madhe në notat 8 dhe 9, ndërsa djemtë në notat 7 dhe 8.

Tabela 1.9: Arritjet e *PKAB-së* sipas gjinisë.

Gjinia	Notat e PKAB-së në Gjuhën Shqipe						
	Nota 4	Nota 5	Nota 6	Nota 7	Nota 8	Nota 9	Nota 10
Vajza	0.02%	1.02%	2.47%	7.51%	12.82%	13.60%	11.57%
Djem	0.20%	3.89%	9.05%	14.63%	11.77%	7.20%	4.26%
Në nivel kombëtar	0.22%	4.92%	11.51%	22.14%	24.59%	20.80%	15.83%

Grafiku 1.6: Arritjet në **PKAB** sipas gjinisë.




Tabela 1.10: Arritjet vjetore sipas gjinisë.

Gjinia	Notat vjetore në Gjuhën Shqipe					
	Nota 5	Nota 6	Nota 7	Nota 8	Nota 9	Nota 10
Vajza	2.67%	5.67%	7.77%	10.27%	9.76%	12.86%
Djem	13.98%	11.51%	8.64%	7.36%	4.86%	4.65%
Në nivel kombëtar	16.65%	17.18%	16.41%	17.63%	14.63%	17.50%

Për arritjet gjatë vitit shkollor:

- vajzat kanë përqindjen më të lartë në notën 10 me **12.86%** në notën vjetore, ndërsa djemtë kanë notën 5 me **13.98%**;
- vajzat kanë përqindje më të lartë në notat 8 dhe 10, respektivisht me **10.27%** dhe **12.86%**;
- djemtë kanë përqindje më të lartë në notat 5 dhe 6, respektivisht me **13.98%** dhe **11.51%**.

Grafiku 1.7: Arritjet vjetore sipas gjinisë.




Tabela 1.11: paraqet informacion mbi nivelin e qëndrueshmërisë së rezultateve vjetore, të krahasuara me rezultatet e fituara në provimin e arsimit bazë për lëndën e Gjuhës shqipe.

Tabela 1.11: lexohet si më poshtë:

- nga rreshti i parafundit i tabelës, lexojmë se, nga totali i nxënësve të vlerësuar gjatë vitit shkollor me notën 10 në lëndën e Gjuhës shqipe përbëjnë **17.50%**, ndërkohë që, nxënësit të cilët e kanë ruajtur vlerësimin me notën 10 në provimin e gjuhës shqipe përbëjnë **10.27%** të totalit të nxënësve;
- nëse rezultatet e nxënësve do të ishin të qëndrueshme, atëherë në PKAB duhet të rezultonin **17.50%** nota **10** në nivel kombëtar. Ndërkohë, ka ndodhur që nxënës të vlerësuar me notën **10** në procesin mësimor vjetor, në provimin kombëtar janë vlerësuar me notën **6 (0.02%)**, notën **7 (0.27%)**, notën **8 (1.81%)**, notën **9 (5.13%)** dhe notën **10 (10.27%)**;
- këto shifra tregojnë se nxënësit e vlerësuar me notën **10** gjatë vitit shkollor, në provimin kombëtar janë vlerësuar edhe me notën **6, 7, 8** apo **9**. Pra, vlerësimi i tyre është ulur me **1** deri në **4** nota.

Të dhënat e **Tabelës 1.11** tregojnë se një përqindje e caktuar e nxënësve, të cilët janë vlerësuar gjatë vitit shkollor me notën **5** e **6**, në provimin kombëtar kanë arritur të marrin vlerësimin **7, 8, 9** dhe **10**.

Nga **17.18%** e nxënësve që gjatë vitit shkollor janë vlerësuar me notën **6**, vetëm **3.67%** e tyre kanë mbajtur po atë notë në provimin kombëtar.


Dukuria e *paqëndrueshmërisë së njohurive* lidhet me shkallën e fiktivitetit në shkollë, ndërsa dukuria e vlerësimit me **4-5** nota më lartë në provimin kombëtar tregon për *nivel të ulët të monitorimit të mjediseve të provimit*.

Tabela 1.11: Vlerësimi i qëndrueshmërisë së notës.

Notat vjetore në %		Notat e <i>PKAB</i> -së në përqindje						
		Nota 4	Nota 5	Nota 6	Nota 7	Nota 8	Nota 9	Nota 10
5	16.65%	0.16%	3.30%	5.78%	5.98%	1.22%	0.18%	0.02%
6	17.18%	0.05%	1.17%	3.67%	6.79%	4.71%	0.70%	0.09%
7	16.41%	0.01%	0.27%	1.43%	5.38%	6.04%	2.97%	0.32%
8	17.63%	0.00%	0.15%	0.51%	2.72%	6.90%	5.54%	1.80%
9	14.63%	0.00%	0.02%	0.11%	1.00%	3.91%	6.27%	3.33%
10	17.50%	0.00%	0.00%	0.02%	0.27%	1.81%	5.13%	10.27%
Gjithsej	100%	0.22%	4.92%	11.51%	22.14%	24.59%	20.80%	15.83%

1.9 Të dhëna të tjera për rezultatet e provimit të Gjuhës shqipe

Grafiku 1.8: Shpërndarja e pikëve për provimin e arsimit bazë, Gjuhë Shqipe.



Grafiku 1.8, paraqet shpërndarjen e pikëve të fituara nga nxënësit në provimin e arsimit bazë, në lëndën “Gjuhë shqipe” 2024. Grafiku tregon se kemi një shpërndarje normale të arritjeve të nxënësve në provimin e arsimit bazë. Maksimumi është arritur në 45 pikë/nxënës nga 1169 nxënës.

Në përfundim mund të themi:

Rezultatet e arritjeve të nxënësve në testin e **Gjuhës shqipe, PKAB 2024**, (duke u nisur nga të dhënat e mësipërme) klasifikohen si më poshtë:

- *Dobët* (vlerësuar me notën **4** në **PKAB 2024**). Sipas statistikave rezulton se **0.22%** e nxënësve nuk e kanë kapërcyer nivelin minimal të arritjeve.
- *Mjaftueshëm* (përfshihen nxënësit që kanë nivelin e parë dhe që kanë fituar notën **5** dhe **6**). Nga tabela rezulton se **4.92%** e nxënësve kanë marrë notën **5** dhe **11.51%** e nxënësve kanë marrë notën **6**. Nga një analizë e këtyre të dhënave, vërejmë se ky grup nxënësish kanë siguruar arritjet e mëposhtme:
 - përdorin drejt njohuritë për të kuptuar në mënyrë *të përgjithshme* tekstin;
 - dallojnë faktin nga opinioni;
 - gjejnë kuptime të fjalëve të thjeshta;
 - identifikojnë detajet më të dukshme;
 - zbulojnë temën kryesore të fragmenteve;
 - dallojnë numrin njëjës dhe shumës;
 - përmbahen brenda temës së esesë;
 - shtjellojnë *shumë pak* idenë e një paragrafi;
 - zbulojnë raporte të thjeshta shkak-pasojë;
 - shkruajnë saktë fjalë të thjeshta;
 - dallojnë lidhëzat dhe klasat më kryesore të fjalëve (emër, mbiemër);
 - perifrazojnë në mënyrë *sipërfaqësore* informacionet kryesore të tekstit.
- *Mirë* (përfshihen nxënësit që kanë fituar nivelin e dytë të arritjeve, nivel që përkon me notat **7-8**), ku **22.14%** e nxënësve kanë fituar notën **7** dhe **24.59%** kanë fituar notën **8**. Nxënësit e këtij grupimi, në përputhje me kompetencat e arritjeve, zotërojnë aftësitë e mëposhtme:
 - bëjnë shpjegime të pjesshme, duke u bazuar në tekstet;
 - dallojnë idenë kryesore të tekstit;
 - argumentojnë në mënyrë të përgjithshme mendimet e tyre;
 - analizojnë fjali të thjeshta që realizojnë përshkrime të personazheve;
 - dallojnë marrësin e mesazhit në skemën e komunikimit;
 - zbulojnë gjendjen shpirtërore të personazhit;
 - dallojnë përemrat, parafjalët dhe trajtat e shkurtra;
 - zbulojnë shkallët e mbiemrave;
 - shpjegojnë llojet e kallëzuesve të thjeshtë e të përbërë;
 - shpjegojnë funksionet e fjalëve në fjali;
 - organizojnë fakte dhe ide në përshtatje me qëllimin dhe llojin e tekstit;
 - përdorin *relativisht* drejt shenjat e pikësimit.
- *Shumë mirë* (përfshin nivelin e tretë të arritjeve, që përkon më notat **9** dhe **10**). Nga tabela rezulton se **20.80%** e nxënësve kanë marrë notën **9** dhe **15.83%** kanë marrë notën **10**, të

cilët, në përputhje me kompetencat e arritjeve, zotërojnë, veç të tjerash, edhe aftësitë e mëposhtme:

- vlerësojnë në thellësi informacionet në tekst;
- bëjnë lidhje mes tekstit dhe ideve të tjera jashtë tekstit në një situatë të re;
- ndërtojnë lloje të ndryshme fjalish;
- nxjerrin përfundime mbi çështje të rëndësishme në tekst;
- përfytyrojnë situata që rrjedhin nga logjika e tekstit;
- përdorin strategji personale për të bindur lexuesin;
- përshtatin në kohë e mënyrë gjymtyrët kryesore dhe të dyta të fjalisë;
- përdorin drejt në të gjitha rastet shenjat e pikësimit;
- interpretojnë informacionet e marra nga teksti me burime të tjera të informacionit;
- kanë stil origjinal në punën me shkrim;
- formojnë fjali të llojeve të ndryshme, duke përdorur drejt rregullat e koherencës dhe kohezionit;
- analizojnë në thellësi personazhet e fragmenteve.

II. Lënda: Matematikë

2.1 Arritjet e nxënësve

Tabela 2.1: Arritjet mesatare për çdo ZVAP

Nr	ZVAP	Pikë mesatare	Shmangia mesatare	Nota mesatare e provimit	Shmangia mesatare	Nota mesatare vjetore	Shmangia mesatare
Në nivel kombëtar		30.84	10.31	7.67	1.42	7.07	1.74
1	Belsh	28.58	13.56	8.07	1.29	8.07	1.29
2	Berat	31.71	9.74	7.79	1.36	7.29	1.73
3	Bulqizë	25.81	9.36	7.04	1.36	6.47	1.72
4	Cërrik	26.37	10.28	7.06	1.50	6.87	1.80
5	Devoll	32.36	9.10	7.83	1.25	7.24	1.77
6	Dibër	27.62	9.10	7.25	1.25	6.62	1.61
7	Dimal	20.04	8.84	6.17	1.29	6.90	1.69
8	Divjakë	29.86	8.20	7.54	1.14	6.98	1.66
9	Durrës	33.91	9.80	8.09	1.35	7.03	1.78
10	Elbasan	33.59	10.60	8.02	1.42	7.05	1.77
11	Fier	30.63	9.01	7.64	1.27	7.00	1.66
12	Finiq-Dropull	34.89	9.99	8.07	1.39	7.24	1.68
13	Gjirokastër-Libohovë	29.76	9.31	7.59	1.29	7.27	1.81
14	Gramsh	33.14	9.20	7.98	1.29	7.16	1.69
15	Has	25.78	8.31	7.02	1.20	7.22	1.79
16	Kamëz	26.49	8.54	7.11	1.20	6.59	1.58
17	Kavajë	31.24	12.44	7.66	1.67	6.99	1.90
18	Klos	26.31	8.58	7.16	1.19	6.93	1.68
19	Kolonjë	32.09	7.93	7.81	1.10	7.08	1.89
20	Korçë-Pustec	33.65	10.38	8.09	1.40	7.25	1.86
21	Krujë	29.66	9.45	7.51	1.30	6.91	1.59
22	Kuçovë	27.51	9.41	7.24	1.33	6.76	1.63
23	Kukës	25.68	9.60	6.98	1.39	7.08	1.70
24	Kurbin	31.12	10.45	7.68	1.44	7.35	1.68
25	Lezhë	29.61	10.45	7.50	1.45	6.97	1.63
26	Librazhd	33.23	9.40	7.91	1.27	7.28	1.65
27	Lushnje	34.54	10.69	8.16	1.47	7.22	1.79
28	Malësi e Madhe	29.16	8.08	7.43	1.10	6.57	1.67
29	Maliq	26.48	10.42	7.11	1.43	6.62	1.71
30	Mallakastër	33.87	8.75	8.05	1.20	7.10	1.79
31	Mat	30.67	10.11	7.65	1.40	6.69	1.73
32	Mirditë	27.60	9.73	7.30	1.39	6.93	1.66
33	Patos	28.98	8.12	7.43	1.12	6.80	1.59

34	Peqin	32.19	11.01	7.84	1.54	7.56	1.71
35	Përmet-Këlcyrë	28.01	9.06	7.31	1.22	6.43	1.48
36	Pogradec	30.33	10.56	7.55	1.51	7.15	1.73
37	Poliçan	31.94	8.48	7.80	1.20	6.96	1.53
38	Prrenjas	29.31	9.61	7.53	1.30	6.95	1.73
39	Pukë-Fushë Arrëz	30.00	10.16	7.54	1.43	7.44	1.70
40	Roskovec	28.81	8.50	7.38	1.20	6.53	1.63
41	Rrogozhinë	28.47	11.30	7.29	1.66	6.97	1.78
42	Sarandë-Konispol-Delvinë	29.53	10.03	7.53	1.37	6.99	1.70
43	Selenicë	27.54	10.22	7.22	1.43	7.10	1.72
44	Shijak	26.90	9.86	7.19	1.40	6.71	1.58
45	Shkodër	30.39	9.22	7.55	1.30	6.94	1.73
46	Skrapar	29.76	10.05	7.57	1.43	6.66	1.68
47	Tepelenë-Memaliaj	27.19	8.40	7.21	1.19	7.19	1.72
48	Tiranë	32.75	10.47	7.92	1.44	7.29	1.78
49	Tropojë	33.57	9.59	8.07	1.33	7.54	1.67
50	Vau Dejës	22.77	8.21	6.49	1.17	6.45	1.48
51	Vlorë-Himarë	30.28	10.52	7.58	1.48	7.18	1.74
52	Vorë	28.08	9.35	7.31	1.31	6.68	1.60

Tabela 2.1 paraqet pikët mesatare të fituara nga nxënësit e çdo ZVAP, në provimin kombëtar të Matematikës.

Nisur nga **Tabela 2.1**, duket vihet re se:

- Pikët mesatare në nivel kombëtar janë **30.84** pikë/nxënës.
- ZVAP Finiq-Dropull kryeson me pikët mesatare më të larta (**34.89**), pra me **4.05** pikë/nxënës më shumë se ai kombëtar.

Kjo ZVAP ka gjithashtu edhe rritje të notës mesatare të **PKAB**-së nga ajo vjetore, me **0.83 njësi note**.

- Ndërsa ZVAP Dimal, ka rezultatet më të ulëta në pikë mesatare për nxënës, vetëm **20.04** duke rezultuar me **10.8 pikë/nxënës** më pak se treguesi kombëtar. Kjo ZVAP ka gjithashtu edhe një rënie të cilësisë së notës vjetore 0.73 njësi note.

2.2 Arritjet në nivel kombëtar

Në provimin e arsimit bazë, lënda Matematikë, morën pjesë **27417** nxënës.

Tabela 2.2: Arritjet mesatare të nxënësve sipas kategorive.

Urbanizimi	Gjinia	Pikët e fituara në test		Nota e PKAB		Nota Vjetore	
		Mesatarja e pikëve	Shmangia mesatare	Nota mesatare	Shmangia mesatare	Nota mesatare	Shmangia mesatare
Në nivel kombëtar	Vajza	33.39	10.03	8.02	1.38	7.56	1.69
	Djem	28.40	9.98	7.34	1.38	6.59	1.66
	Total	30.84	10.31	7.67	1.42	7.07	1.74
Urbane	Vajza	35.50	9.73	8.29	1.35	7.73	1.72
	Djem	30.84	10.16	7.66	1.40	6.84	1.74
	Total	33.14	10.22	7.97	1.41	7.28	1.78
Rurale	Vajza	30.02	9.55	7.58	1.31	7.30	1.61
	Djem	24.68	8.45	6.85	1.20	6.21	1.45
	Total	27.26	9.39	7.20	1.30	6.74	1.62
Publik (në nivel kombëtar)	Vajza	32.72	9.97	7.93	1.37	7.46	1.68
	Djem	27.59	9.73	7.23	1.35	6.46	1.61
	Total	30.10	10.18	7.57	1.40	6.95	1.72
Urbane	Vajza	34.78	9.78	8.20	1.35	7.60	1.73
	Djem	29.88	10.04	7.53	1.39	6.66	1.69
	Total	32.29	10.22	7.86	1.41	7.12	1.77
Rurale	Vajza	29.93	9.53	7.56	1.30	7.28	1.60
	Djem	24.60	8.41	6.84	1.19	6.21	1.45
	Total	27.18	9.36	7.19	1.30	6.73	1.62
Jopublik (në nivel kombëtar)	Vajza	39.26	8.49	8.79	1.20	8.42	1.49
	Djem	35.99	9.10	8.36	1.27	7.81	1.61
	Total	37.64	8.95	8.58	1.25	8.12	1.58
Urbane	Vajza	39.34	8.50	8.80	1.20	8.42	1.49
	Djem	36.24	9.05	8.39	1.26	7.85	1.61
	Total	37.81	8.91	8.60	1.25	8.14	1.58
Rurale	Vajza	37.64	8.23	8.67	1.12	8.49	1.29
	Djem	31.22	8.78	7.69	1.25	7.05	1.49
	Total	34.33	9.07	8.17	1.28	7.75	1.57

Në tabelën 2.2, paraqiten arritjet mesatare të nxënësve në lëndën e Matematikës në **nivel kombëtar**, sipas **vendbanimit urban/rural** (referuar vendndodhjes së shkollës), sipas **gjinisë vajza/djem**, dhe sipas **sistemit publik/jopublik** të edukimit.

Në nivel kombëtar vihet re se:

- **mesatarja e pikëve** të fituara në provimin e arsimit bazë në lëndën e Matematikës është **30.84 pikë**, me shmangie mesatare **10.31**;
- **nota mesatare e provimit të arsimit bazë** është **7.67**, me shmangie mesatare **1.42**;
- **nota mesatare vjetore** është **7.07**, me shmangie mesatare **1.74**.

Në nivel kombëtar, nga krahasimi i vlerave të notës mesatare në provimin e arsimit bazë me notën mesatare vjetore, rezulton se ndryshueshmëria është me një rritje prej **0.6** njësi note.

Rezultatet e nxënësve në provimin e arsimit bazë janë më të larta, krahasuar me arritjet vjetore të nxënësve.

2.3 Arritjet sipas vendbanimit urban/rural

Nëse analizojmë arritjet e nxënësve në nivel kombëtar, sipas elementëve të vendbanimit urban/rural të paraqitura në tabelën 2.2, rezulton se **mesatarja e pikëve të nxënësve të zonave urbane është më e lartë, ndaj nxënësve të zonave rurale** dhe konkretisht për çdo kategori kemi:

- në nivel kombëtar, arritjet e nxënësve sipas kategorive të vendbanimit urban/rural, tregojnë se kemi diferenca të dukshme mes arritjeve të nxënësve që kanë ndjekur shkollën në zonat urbane, kundrejt atyre që kanë ndjekur shkollën në zonat rurale. Mesatarja e pikëve të nxënësve të zonave urbane rezulton të jetë **5.88 pikë** më e lartë ndaj nxënësve të zonave rurale.
- për sistemin publik, mesatarja e pikëve të nxënësve të zonave urbane është **5.11 pikë** më e lartë ndaj nxënësve të zonave rurale.
- për sistemin jopublik, mesatarja e pikëve të nxënësve të zonave urbane është **3.48 pikë** më e lartë ndaj nxënësve të zonave rurale.

2.4 Arritjet sipas gjinisë

Të dhënat e tabelës 2.2 tregojnë se:

- në provimin e arsimit bazë, lënda Matematikë, arritjet mesatare të vajzave janë më të larta, krahasuar me arritjet mesatare të djemve.
- arritjet mesatare të vajzave janë **2.55 pikë** mbi mesataren e pikëve mesatare në nivel kombëtar.
- mesatarja e pikëve të fituara nga vajzat, në nivel kombëtar, është **33.39 pikë/nxënës**, ose **4.99 pikë/nxënës** më e lartë, se mesatarja e pikëve të fituara nga djemtë.
- arritjet e vajzave në provimin e arsimit bazë janë **0.46 njësi note** më të lartë, kundrejt arritjeve vjetore (në nivel kombëtar: **8.02** nota mesatare e **PKAB**-së; **7.56** nota mesatare vjetore).
- për djemtë arritjet në provimin e **PKAB**-së janë **0.75 njësi note** më të larta kundrejt rezultateve vjetore të tyre (në nivel kombëtar: **7.34** nota mesatare **PKAB**; **6.59** nota mesatare vjetore).

2.5 Arritjet sipas sistemit publik/jopublik të edukimit

Nga analiza e të dhënave rezulton se:

- arritjet mesatare të nxënësve në sistemin jopublik të edukimit janë më të larta se arritjet e nxënësve të sistemit publik, kjo si për mesataren e pikëve mesatare për nxënës të fituara në provim, po ashtu edhe për notën mesatare **PKAB** dhe atë vjetore.
- diferenca e pikëve mesatare mes sistemit jopublik dhe atij publik në nivel kombëtar është **7.54** pikë/nxënës.
- në sistemin jopublik, ashtu si dhe në atë publik, arritjet e nxënësve në provimin e arsimit bazë janë më të larta, krahasuar me arritjet vjetore të tyre. Për sistemin jopublik kjo diferencë është **0.46** njësi note, ndërsa për atë publik, diferenca midis arritjeve në provimin e arsimit bazë me arritjet vjetore është **0.62** njësi note.

2.6 Qëndrueshmëria e arritjeve

Nëse do të analizojmë qëndrueshmërinë e arritjeve të nxënësve në provimin e arsimit bazë, kundrejt arritjeve vjetore, për lëndën e Matematikës, shihet se:


- si për sistemin publik edhe për atë jopublik, arritjet e nxënësve të zonave rurale janë më të qëndrueshme, krahasuar me arritjet e nxënësve të zonave urbane.

Tabela 2.3: Shpërndarja e notave për lëndën e Matematikës.

Sistemi i edukimit	Notat e PKAB-së në Matematikë						
	Nota 4	Nota 5	Nota 6	Nota 7	Nota 8	Nota 9	Nota 10
Publik	0.05%	5.50%	15.70%	24.97%	20.11%	13.12%	10.68%
Jopublik	0.01%	0.08%	0.39%	1.79%	2.18%	2.32%	3.09%
Në nivel kombëtar	0.06%	5.58%	16.09%	26.76%	22.29%	15.45%	13.77%

Tabelat 2.3 dhe 2.4 paraqesin shpërndarjen (në përqindje) të notave të **PKAB-së** dhe notave vjetore për lëndën e Matematikës.

Grafiku 2.1: Shpërndarja në % e notave të PKAB-së për lëndën e Matematikës.




Në provimin e arsimit bazë, në nivel kombëtar:

- kalueshmëria është **99.94%**;
- nota mbizotëruese është **nota 7** me **26.76%**;
- përqëndrimi më i madh është në notat **6, 7, 8** të cilat së bashku përbëjnë **65.14%**;
- përqindja e nxënësve të vlerësuar me notën **10** shkon në **13.77%**.

Tabela 2.4: Shpërndarja e notave vjetore për lëndën e Matematikës.

Sistemi i edukimit	Nota e vjetore në Matematikë					
	Nota 5	Nota 6	Nota 7	Nota 8	Nota 9	Nota 10
Publik	24.97%	18.67%	13.76%	12.13%	9.88%	10.73%
Jopublik	0.66%	1.14%	1.61%	2.09%	1.62%	2.74%
Në nivel kombëtar	25.63%	19.81%	15.37%	14.22%	11.50%	13.47%


Grafiku 2.2: Shpërndarja e notave vjetore për lëndën e Matematikës.



Për notat vjetore, në nivel kombëtar vihet re se:

- nota mbizotëruese është nota **5 me 25.63%**;
- përqëndrimi më i madh është në notat **5, 6 dhe 7**, të cilat së bashku përbëjnë **60.81%**;
- përqindja e nxënësve të vlerësuar me notën **9** shkon në **11.50%**;
- përqindja e nxënësve të vlerësuar me notën **10** shkon në **13.47%**.

Grafiku 2.3: Arritjet ne provimin e Matematikës



Grafiku 2.3 paraqet një krahasimin midis arritjeve në provimin e arsimit bazë dhe atyre vjetore.

2.7 Arritjet sipas vendbanimit urban/rural

Tabela 2.5: Shpërndarja e notave të Matematikës sipas urbanizimit.

Urbanizimi	Nota e PKAB në Matematikë						
	Nota 4	Nota 5	Nota 6	Nota 7	Nota 8	Nota 9	Nota 10
Urbane	0.04%	2.39%	6.87%	14.69%	14.19%	11.28%	11.43%
Rurale	0.02%	3.19%	9.22%	12.08%	8.10%	4.17%	2.34%
Në nivel kombëtar	0.06%	5.58%	16.09%	26.77%	22.29%	15.45%	13.77%

Tabela 2.5 paraqet arritjet në provimin e arsimit bazë, lënda Matematikë, sipas urbanizimit.

Sipas të dhënave të tabelës 2.5, vihet re:

- Përqindja e nxënësve që kanë marrë notën **10** në provimin e arsimit bazë, është **13.77%** e numrit të përgjithshëm të nxënësve, prej të cilëve vetëm **2.34%** janë nxënës që i përkasin zonave rurale, ndërsa pjesa tjetër prej **11.43%** i përkasin zonave urbane.
- Shihet se, për zonat urbane, nota me përqindjen më të lartë është nota **7** me **14.69%**, gjithashtu edhe për zonat rurale është nota **7**, me **12.08%** të nxënësve.

Tabela 2.6: Shpërndarja e notave vjetore të Matematikës, sipas urbanizimit.

Urbanizimi	Nota vjetore në Matematikë					
	Nota 5	Nota 6	Nota 7	Nota 8	Nota 9	Nota 10
Urbane	13.65%	11.16%	9.10%	9.03%	7.59%	10.36%
Rurale	11.98%	8.66%	6.27%	5.19%	3.91%	3.11%
Në nivel kombëtar	25.63%	19.81%	15.37%	14.22%	11.50%	13.47%

- për notat vjetore, sipas vendbanimit urban/rural vërejmë se **13.47%** e nxënësve ka marrë notën **10**;
- gjithashtu vihet re se notën **10** e kanë marrë **10.36%** e nxënësve të zonave urbane dhe **3.11%** e nxënësve të zonave rurale;
- nota me përqindjen më të lartë në nivel kombëtar është nota **5**, të cilën e kanë marrë **25.63%** e nxënësve.

2.8 Arritjet sipas gjinisë vajza/djem

Tabela 2.7: Shpërndarja e notave të Matematikës sipas gjinisë.

Gjinia	Nota e PKAB në Matematikë						
	Nota 4	Nota 5	Nota 6	Nota 7	Nota 8	Nota 9	Nota 10
Vajza	0.02%	1.58%	5.23%	11.54%	12.08%	9.49%	9.07%
Djem	0.04%	4.00%	10.86%	15.22%	10.21%	5.96%	4.70%
Në nivel kombëtar	0.06%	5.58%	16.09%	26.76%	22.29%	15.45%	13.77%

Tabela 2.7 paraqet arritjet në provimin e arsimit bazë, lënda Matematikë, sipas gjinisë.

Tabela 2.8: Shpërndarja e notave vjetore të Matematikës sipas gjinisë.

Gjinia	Nota e vjetore në Matematikë					
	Nota 5	Nota 6	Nota 7	Nota 8	Nota 9	Nota 10
Vajza	6.75%	9.14%	8.45%	8.27%	7.35%	9.04%
Djem	18.88%	10.67%	6.92%	5.95%	4.15%	4.43%
Në nivel kombëtar	25.63%	19.81%	15.37%	14.22%	11.50%	13.47%


Për lëndën e Matematikës, rezulton se:

- vajzat kanë rezultate më të larta se djemtë, si gjatë vitit shkollor, po ashtu edhe në provimin e arsimit bazë;
- përqindja e nxënësve që kanë marrë notën **10** në provimin e arsimit bazë, është **13.77%** e totalit të nxënësve, prej të cilëve **9.07%** janë vajza dhe vetëm **4.70%** janë djem;
- përqindja e mbetësve në provimin e arsimit bazë, për kategorinë e djemve (**0.04%**) është më e madhe krahasuar me kategorinë e vajzave (**0.02%**);
- në rezultatet e provimit të arsimit bazë, për vajzat nota me përqindjen më të lartë është nota **8** (me **12.08%**), ndërsa për djemtë është nota **7** (me **15.22%**);


- në rezultatet vjetore, vihet re se për djemtë nota 5 ka përqindjen më të madhe (**18.88%**) ndërsa për vajzat nota me përqindjen më të madhe është 6 (me **9.14%**);
- përqindja e nxënësve të vlerësuar me notën 10 gjatë procesit mësimor vjetor është **13.47%**, prej të cilëve **9.04%** janë vajza dhe **4.43%** djem. Nëse krahasojmë notën vjetore me notën e **PKAB**-së, nota vjetore është më e ulët. Në PKAB, nota 10 është **0.3%** më e lartë se nota vjetore.

Më poshtë paraqiten grafikisht të dhënat e tabelave 2.7 dhe 2.8.


